

<p style="text-align: center;">STATUT</p> <p style="text-align: center;">I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR OLV SHPK</p>	<p style="text-align: center;">ARTICLES OF ASSOCIATION</p> <p style="text-align: center;">OF THE LIMITED LIABILITY COMPANY OLV SHPK</p>
<p style="text-align: center;">Neni 1</p> <p style="text-align: center;">Data e Themelimit dhe Emri, dhe Forma Ligjore</p> <p>1.1 Sot, në Tiranë, më datë 9.1.2023, themelohet shoqëria OLV SHPK ("Shoqëria").</p> <p>1.2 Forma ligjore e shoqërisë është "Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar", e rregulluar sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, dhe veçanërisht ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" ("Ligji i Shoqërive").</p> <p>1.3 Emri i shoqërisë ndiqet në mënyrë të pandashme nga shkurtimi në shqip "SHPK".</p>	<p style="text-align: center;">Article 1</p> <p style="text-align: center;">Establishment Date, Name and the Legal Form</p> <p>1.1 Today, in Tirana, on 9.1.2023, it is established the Company OLV SHPK (the "Company").</p> <p>1.2 The form of the Company is of a "Limited Liability Company", regulated in accordance with the laws of the Republic of Albania, and particularly the Law No. 9901, dated on 14.04.2008 "On Entrepreneurs and Commercial Companies" (the "Companies Law").</p> <p>1.3 The name of the Company is associated indispensably with the Albanian acronyms "SHPK".</p>
<p style="text-align: center;">Neni 2</p> <p style="text-align: center;">Selia shoqërisë</p> <p>2.1 Selia e Shoqërisë është në adresën Rruga: BLV. "ZHAN D'ARK", Nd. 53, H. 1, Kodi postar 1017, Njësia Administrative 2, Tiranë, Shqipëri.</p> <p>2.2 Shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi të saj brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 2</p> <p style="text-align: center;">Legal Seat of the Company</p> <p>2.1 The legal seat of the Company is Rruga: BLV. "ZHAN D'ARK", Nd. 53, H. 1, Kodi postar 1017, Njësia Administrative 2, Tirana, Albania.</p> <p>2.2 The Company may open its branches and representative offices within or outside the Republic of Albania.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 3</p> <p style="text-align: center;">Kohëzgjatja</p> <p>Kohëzgjatja e Shoqërisë është për një periudhë kohe të pacaktuar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 3</p> <p style="text-align: center;">Company Duration</p> <p>3.1 The duration of the Company is for an unlimited period of time.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 4</p> <p style="text-align: center;">Objekti i Veprimtarisë</p> <p>Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:</p> <p>4.1 Prodhimi, transmetimi, shpërndarja dhe shitja e energjisë elektrike së prodhuar nga burime të rinovueshme nga burimet diellore, të erës apo hidrike.</p> <p>4.2 Studimi, projektimi, ndërtimi, rehabilitimi dhe fuqizimi i paneleve dhe centraleve për prodhimin e energjisë elektrike dhe infrastrukturës së impianteve të prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe shitjes së energjisë elektrike nga burime të rinovueshme nëpërmjet paneleve dhe parqeve fotovoltaike, hidrike dhe eolike.</p> <p>4.3 Kërkimi dhe zhvillimi i impianteve dhe aparaturave për prodhimin e energjisë elektrike.</p> <p>4.4 Ofrimi i asistencës teknike, riparimit dhe mirëmbajtjes së aparaturave, impianteve dhe linjave për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.</p>	<p style="text-align: center;">Article 4</p> <p style="text-align: center;">The Scope of Activities</p> <p>The scope of activities of the Company shall be the following:</p> <p>4.1 Generation, transmission, distribution and sale of electricity generated from renewable resources, especially wind, solar and water.</p> <p>4.2 Study, design, construction, rehabilitation and retrofitting of panels and power stations for the study, design, construction, rehabilitation and retrofitting of panels and power stations for electricity generation and infrastructure of facilities for the generation, transmission, distribution and sale of electricity from renewable sources through wind parks, photovoltaic power plants and hydroelectric power plants.</p> <p>4.3 Research and development of plants and devices for electricity generation.</p> <p>4.4 Provision of technical assistance, repair and maintenance of devices, installations and lines for</p>

[Handwritten signatures]

<p>4.5 Ndërtimi, mirëmbajtja dhe operimi i linjave të transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike.</p> <p>4.6 Ndërtimi i linjave për prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovueshme, ndërtimi dhe aktivitete të tregtimit në të gjitha format e materialeve të ndërtimit.</p> <p>4.7 Ndërmjetësim me komision për blerjen, shitjen, prodhimin, instalimin e sistemeve të burimeve të energjisë së rinovueshme, parqeve diellore, turbinave me erë dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për të tjerët.</p> <p>4.8 Marketingun dhe prodhimin e sistemeve elektronike, komponentët e sistemet periferike për burimet e rinovueshme.</p> <p>4.9 Shërbimet e komisionit financiar të ndërmjetësimit për blerjen, shitjen, prodhimin instalimin e sistemeve të ripërtëritshme të energjisë, formave diellore, turbinave të erës dhe sistemeve hidroelektrike të shfrytëzuara për vete ose për llogari të palëve të treta.</p> <p>4.10 Importi dhe eksporti me shumicë dhe pakicë i energjisë elektrike, mallrave, materialeve dhe aparatave që lidhen me kryerjen e aktivitetit të shoqërisë dhe të lejuara nga legjislacioni në fuqi për shoqërinë.</p> <p>4.11 Kryerja e çdo aktiviteti të lejuar në Republikën e Shqipërisë i cili është në funksion ose jo të objektit të kësaj shoqërie.</p>	<p>the generation, transmission and distribution of electricity.</p> <p>4.5 Construction, maintenance and operation of electricity transmission and distribution lines.</p> <p>4.6 Construction of lines for the production of electronic systems, components and peripheral systems for renewable sources, construction and trading activities in all types of construction materials.</p> <p>4.7 Brokerage with commission for the purchase, sale, production, installation of renewable energy source systems, solar parks, wind turbines and hydroelectric systems used for itself or third parties.</p> <p>4.8 Marketing and production of electronic systems, components and peripheral systems for renewable sources.</p> <p>4.9 Financial intermediary commission services for the purchase, sale, production and installation of renewable energy systems, solar forms, wind turbines and hydroelectric systems operated for the internal needs of the company or on behalf of third parties.</p> <p>4.10 Wholesale and retail import and export of electricity, goods, materials and devices related to the performance of the company's activity and permitted by the legislation in force for the company.</p> <p>4.11 Carrying out any activity authorized in the Republic of Albania and serving the purpose of the scope of this company or other legal activities.</p>
<p>Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet ose shtohet në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi me vendim të Asamblesë së Ortakëve.</p>	<p>The scope of activity of the Company can be altered or increased in accordance with the applicable law by decision of the Assembly of Shareholders.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 5 Kapitali Themeltar</p> <p>5.1 Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerën 100.000 Lekë.</p> <p>5.2 Kapitali do të shlyhet nga ortakët në një ose disa këste brenda dy vjetësh pas regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 5 Share Capital</p> <p>5.1 The share capital of the Company is ALL 100.000.</p> <p>5.2 The capital shall be paid by the Shareholders in one or more installments within two years after the registration of the Company with the National Business Centre.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 6 Ortakët dhe Kuotat e tyre</p> <p>6.1 Kapitali i Shoqërisë përbëhet nga katër kuota të zotëruara nga ortakët e mëposhtëm:</p> <p>6.1.1 FEKA İNŞAAT SANAYİ VE TİCARET A.Ş., shoqëri aksionare e të drejtës turke, me adresë në Kızılüzüm Cad. Nr: 15 Kemalpaşa/İzmir, Turqi;</p> <p>6.1.2 5-R D.E.G SHPK, shoqëri e të drejtës shqiptare, me NUIS M02129504T, dhe adresë në Ish Kompleksi SZ Xhafzotaj, Durrës, Shqipëri;</p>	<p style="text-align: center;">Article 6 The Shareholders and their Quotas</p> <p>6.1 The share capital is composed of four quotas owned by the following shareholders:</p> <p>6.1.1 FEKA İNŞAAT SANAYİ VE TİCARET A.Ş., a Turkish joint stock company with its address at Kızılüzüm Cad. No:15 Kemalpaşa/İzmir, Türkiye;</p> <p>6.1.2 5-R D.E.G SHPK, a company duly established and operating under the laws of the Republic of Albania, with Tax Identification</p>

<p>6.1.3 Utku Yönder, shtetas turk, identifikuar me Pasaportë Nr. U22142922, lindur më 29.5.1977 në Eskisehir, Turqi; dhe</p> <p>6.1.4 Naim Idrizi, shtetas i Republikës së Maqedonisë së Veriut, identifikuar me Pasaportë Nr. K1101654, lindur më 13.6.1992 në Tetovë, Maqedoni e Veriut.</p> <p>6.2 Pjesëmarrja e secilit prej ortakëve në kapitalin themeltar të Shoqërisë do të jetë si më poshtë:</p> <p>6.2.1 FEKA INŞAAT SANAYI VE TİCARET A.Ş. zotëron një kuotë që përfaqëson 87% të kapitalit themeltar, me vlerë 87.000 Lekë;</p> <p>6.2.2 5-R D.E.G SHPK zotëron një kuotë që përfaqëson 9% të kapitalit themeltar, me vlerë 9.000 Lekë;</p> <p>6.2.3 Utku Yönder zotëron një kuotë që përfaqëson 2% të kapitalit themeltar, me vlerë 2.000 Lekë; dhe</p> <p>6.2.4 Naim Idrizi zotëron një kuotë që përfaqëson 2% të kapitalit themeltar, me vlerë 2.000 Lekë.</p> <p>6.3 Kuotat ose pjesë të tyre janë lirisht të transferueshme brenda ortakëve.</p> <p>6.4 Transferimi i kuotave jashtë rrethit të ortakëve do të bëhet pasi të jetë respektuar e drejta e parablerjes.</p>	<p>Number (NUIS) M02129504T, and legal seat at the following address Ish Kompleksi SZ Xhafzotaj, Durrës, Albania;</p> <p>6.1.3 Utku Yönder, a turkish citizen identified me Passport No: U22142922, born on 29.5.1977 in Eskisehir, Türkiye; and</p> <p>6.1.4 Naim Idrizi, a citizen of North Macedonia, identified with the Passport No: K1101654, born on 13.6.1992 in Tetovo, North Macedonia.</p> <p>6.2 The participation of each of the shareholders in the share capital shall be as follows:</p> <p>6.2.1 FEKA INŞAAT SANAYI VE TİCARET A.Ş. owns a quota representing 87% of the value of the share capital, in the amount of ALL 87.000;</p> <p>6.2.2 5-R D.E.G SHPK owns a quota representing 9% of the value of the share capital, in the amount of ALL 9.000;</p> <p>6.2.3 Utku Yönder owns a quota representing 2% of the value of the share capital, in the amount of ALL 2.000; and</p> <p>6.2.4 Naim Idrizi owns a quota representing 2 % of the value of the share capital, in the amount of ALL 2.000.</p> <p>6.3 Quotas or parts thereof are freely transferable within shareholders.</p> <p>6.4 The transfer of quotas outside the circle of shareholders will be done after the right of pre-emption has been respected.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 7 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar</p> <p>7.1 Kapitali themeltar mund të zmadhohet ose zvogëlohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve në përputhje me Ligjin e Shoqërive.</p> <p>7.2 Zmadhimi i kapitalit mund të realizohet me anë të kontributeve në para ose me anë të kontributeve në natyrë, si dhe me përfshirjen e rezervave (nëse ka) ose fitimit apo kthimit të borxhit në kapital.</p> <p>7.3 Zmadhimi i kapitalit mund të bëhet duke emetuar kuota të reja apo duke rritur vlerën nominale të kuotave ekzistuese.</p>	<p style="text-align: center;">Article 7 Increase and Decrease of the Capital</p> <p>7.1 The share capital may be increased or decreased according to the decisions of the Shareholders Assembly in accordance with the requirements of the Company Law.</p> <p>7.2 The capital may be increased by contributions in cash or in kind, as well as by including reserves (if any) or profits or converting debt into equity.</p> <p>7.3 The capital increase may take place by issuing new quotas or by increasing the par value of the existing quotas.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 8 Të Drejtat dhe Detyrimet e Ortakëve</p>	<p style="text-align: center;">Article 8 Rights and Obligations of the Shareholders</p>

<p>8.1 Ortakët do të kenë akses të plotë në çdo informacion dhe të dhënë që ka lidhje me aktivitetin e Shoqërisë në çdo kohë, përfshirë të drejtën për të kontrolluar regjistrat e Shoqërisë dhe çdo dokument tjetër.</p> <p>8.2 Të drejtat dhe detyrimet që rezultojnë nga zotërimi i Kuotave, transferohen tek çdo zotërues i ri i këtyre Kuotave.</p>	<p>8.1 The shareholders shall have full access to all information and data concerning the Company's activity at any time, including the right to inspect the Company's records and documents.</p> <p>8.2 The rights and obligations resulting from the ownership of Shares are transferred to any new owners of such Shares.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 9 Kompetencat e Asamblesë së Ortakëve</p> <p>9.1 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është organi kontrollues dhe vendimmarrës i Shoqërisë i cili merret vendimet mbi aktivitetin dhe politikat e saj ekonomike dhe tregtare.</p> <p>9.2 Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve do të vendosë në lidhje me çështjet e mëposhtme, por pa u kufizuar vetëm në to:</p> <p>9.2.1 shpërndarjen e dividendit nga fitimet apo rezervat;</p> <p>9.2.2 ndryshimet, apo zëvendësimet në statutin e Shoqërisë;</p> <p>9.2.3 ndryshimin e formës ligjore të Shoqërisë;</p> <p>9.2.4 bashkimin, përqendrimin apo përzierjen me shoqëri të tjera, apo ndarjen e Shoqërisë;</p> <p>9.2.5 zmadhimin dhe/ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë;</p> <p>9.2.6 emërimi dhe shkarkimi i ekspertëve kontabël të autorizuar dhe likuidatorëve;</p> <p>9.2.7 miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë, apo të ndryshimeve të tyre;</p> <p>9.2.8 emërimin, pezullimin apo shkarkimin në çdo kohë të Administratorëve;</p> <p>9.2.9 krijimin, shitjen apo blerjen e ndonjë shoqërie bijë/filiali ose hyrjen në shoqëri të përbashkëta (joint venture) partneritete apo marrëveshje të ngjashme;</p> <p>9.2.10 të aprovojë dhe regjistrojë çdo transferim të kuotave;</p> <p>9.2.11 të vendosë ose të ndërmarrë ndonjë veprim tjetër të shoqërisë për të, ose të fillojë ndonjë procedurë për gjykimin e shoqërisë së falimentuar ose në paaftësi paguese, për rregullimet, përshtatjen, mbrojtjen, lehtësimin ose përbërjen e saj ose për borxhet e saj sipas çdo ligji në lidhje me falimentimin, paaftësinë paguese ose riorganizimin ose çlirimin prej debitorëve ose kërkimin e hyrjes së një urdhri për lehtësimin ose emërimin e një marrësi, administratori të besuar ose zyrtari tjetër të tillë për shoqërinë ose për ndonjë pjesë të konsiderueshme të pasurisë së shoqërisë;</p>	<p style="text-align: center;">Article 9 Powers of the Shareholders Assembly</p> <p>9.1 The General Assembly of Shareholders is the controlling and decision-making body of the Company which makes decisions regarding its activity and upon its economic and commercial policy.</p> <p>9.2 The General Assembly of Shareholders shall resolve on the following Company matters, but not being limited to:</p> <p>9.2.1 distribution of dividends from profits or reserves;</p> <p>9.2.2 amendments and replacement to the articles of association of the Company;</p> <p>9.2.3 change in the legal form of the Company;</p> <p>9.2.4 merger, consolidation or amalgamation with any other Company, or split or division of the Company;</p> <p>9.2.5 increase and/or decrease of the Capital of the Company;</p> <p>9.2.6 Appointment and dismissal of the independent auditors and liquidators;</p> <p>9.2.7 Adoption of the annual statements of accounts and performance reports, and amendments thereof;</p> <p>9.2.8 appointment, suspension and dismissal at any time of the Administrators;</p> <p>9.2.9 the establishment, sale or purchase of any subsidiary or the entry into of any joint venture, partnership or other similar arrangement;</p> <p>9.2.10 approve and register any Transfer of shares;</p> <p>9.2.11 resolve or take any other corporate action to or otherwise institute any proceeding seeking to adjudicate the Company bankrupt or insolvent, arrangements, adjustment, protection, relief or composition of it or its debts under any law relating to bankruptcy, insolvency or reorganization or relief of debtors or seeking entry of an order for relief or appointment of a receiver, trustee or other such official for it or a substantial part of its property;</p> <p>9.2.12 purchase the capital stock (or other equity interest) or substantially all of the assets of a company or other entity;</p> <p>9.2.13 make a general assignment for the benefit of the creditors of the Company or otherwise enter into</p>

0.17-

<p>9.2.12 të blejë kapitalin (ose interesa të tjera të kapitalit) ose në thelb të gjitha aktivet e një shoqërie ose subjekti tjetër;</p> <p>9.2.13 të bëjë një caktim të përgjithshëm në dobi të kreditorëve të Shoqërisë ose ndryshe të hyjë në një skemë ose marrëveshje tjetër në dobi të kreditorëve;</p> <p>9.2.14 braktisjen e Projekteve të Shoqërisë;</p> <p>9.2.15 t'i japë autoritetin e nënshkrimit administratorit(ve);</p> <p>9.2.16 të bëjë një ndryshim material në politikën ose parimet e kontabilitetit;</p> <p>9.2.17 të miratojë fillimin, pushimin apo zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve gjyqësore për pretendime që tejkalojnë vlerën prej 1.000.000 USD;</p> <p>9.2.18 miraton politikat e shpenzimeve të shoqërisë dhe çdo ndryshim të tyre;</p> <p>9.2.19 përgatit buxhetet vjetore dhe çdo ndryshim të tyre;</p> <p>9.2.20 miraton buxhetet dhe procedura për tërheqjen e fondeve nga bankat apo depozituesit e tjerë;</p> <p>9.2.21 të përcaktojë procedurat sipas të cilave do të bëhen kontributet në përputhje me marrëveshjet e ortakëve;</p> <p>9.2.22 të pezullojë veprimtarinë e tregtare të shoqërisë;</p> <p>9.2.23 të hyjë në çdo marrëveshje të re me vlera apo angazhime të konsiderueshme materiale për shoqërinë;</p> <p>9.2.24 të shesë, të përcjellë, të transferojë, të japë me qira ose të disponojë, ose të japë një opsion ose të drejtë tjetër për të blerë, marrë me qira ose në ndonjë mënyrë tjetër për të blerë (qoftë në një transferim ose një seri transferimesh) të gjitha ose një pjesë materiale të pronave të shoqërisë dhe asetet ku aktivet materiale ose pasuria nënkupton asetet ose pronat me vlerë më të madhe se 1.000.000 USD;</p> <p>9.2.25 të marrë hua ose ndryshe të ketë borxh mbi 1.000.000 USD ose të krijojë një linjë kredie në një shumë më të madhe se kjo shumë;</p> <p>9.2.26 të japë kredi mbi 50.000 USD;</p> <p>9.2.27 të japë një garanci ose garanci të ndryshme nga garancitë ose letrat me vlerë të dhëna në rrjedhën e zakonshme të biznesit;</p> <p>9.2.28 të vendosë të ndërmarrë veprime juridike materiale, ose të zbatojë ose mbrojë ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e tij thelbësore, përveç siç kërkohet në përgjigje të një emergjence; dhe</p> <p>9.2.29 të lidhë kontrata me ortakët ose ndonjë degë/bijë të tyre që kërkojnë shpenzime që tejkalojnë një total prej 100.000 USD në vit.</p>	<p>a scheme or other arrangement for the benefit of the creditors;</p> <p>9.2.14 abandon the Projects of the Company;</p> <p>9.2.15 give signature authority to Administrator(s);</p> <p>9.2.16 make a material change in accounting policy or principles;</p> <p>9.2.17 to approve initiation, termination or settlement of judicial claims exceeding the value of USD 1.000.000;</p> <p>9.2.18 approve the Company's Spending Policies and any amendments thereto;</p> <p>9.2.19 prepare annual budgets and any amendments thereto;</p> <p>9.2.20 adopt budgets and procedures for the withdrawal of funds from banks or other depositories;</p> <p>9.2.21 determine the procedures under which contributions shall be made pursuant to shareholders' agreements;</p> <p>9.2.22 suspend the Business activity;</p> <p>9.2.23 enter into any new significant material agreements or commitments;</p> <p>9.2.24 sell, convey, transfer, lease or otherwise dispose of, or grant an option or other right to purchase, lease or otherwise acquire (whether in one transfer or a series of transfers) all or a material part of the Company's properties and assets where material assets or property means assets or properties;</p> <p>9.2.25 borrow or otherwise incur Indebtedness in excess of USD 1.000.000 or establish a credit line in an amount in excess of such amount;</p> <p>9.2.26 make loans in excess of USD 50.000;</p> <p>9.2.27 grant a guarantee or security other than guarantees or securities granted in the ordinary course of business;</p> <p>9.2.28 determine to take material legal action, or enforce or defend any of its substantive rights or obligations, other than as required in response to an emergency; and</p> <p>9.2.29 enter into contracts with Shareholders or any Affiliates thereof requiring expenditures in excess of an aggregate of USD 100.000 per year.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 10</p> <p>Thirrja e Mbledhjes së Asamblesë së Ortakëve</p>	<p style="text-align: center;">Article 10</p> <p>Convocation of the Shareholders Assembly Meeting</p>

<p>10.1 Asambleja e Përgjithshme duhet të mbledhet të paktën një herë në vit.</p> <p>10.2 Asambleja e Përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e Shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda tre muajve në vazhdim.</p> <p>10.3 Asambleja e Përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër, asete të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5% e të gjithë aseteve të Shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.</p> <p>10.4 Asambleja e Përgjithshme thirret kur Shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë asete që i përkasin një ortakut të Shoqërisë, që kanë vlerë më të lartë se 5% e aseteve të Shoqërisë, siç rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.</p> <p>10.5 Në rastet e parashikuara në pikat e mësipërme 10.3 dhe 10.4, Asambleja e Përgjithshme do të vendosë në bazë të një raporti nga një ekspert kontabël i autorizuar, që dorëzohet tek kjo Asamble, përveç rastit kur kjo bërje bëhet në bursë ose bën pjesë në veprimtarinë e zakonshme tregtare të Shoqërisë.</p> <p>10.6 Ortakët do të organizojnë takime me Administratorët çdo tre muaj me qëllim vlerësimin e veprimeve të kryera nga Administratorët gjatë atij tre mujori, diskutimin e çështjeve që kanë të bëjnë me administrimin e Shoqërisë dhe marrjen e vendimeve mbi çështjet që janë objekt i aprovimit nga ana e ortakëve.</p> <p>10.7 Në rastet e parashikuara në pikat e mësipërme 10.3 deri 10.6 Asambleja e Përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.</p>	<p>10.1 The General Assembly shall be convened at least once a year.</p> <p>10.2 The General Assembly should be convened in the event that, on the basis of the annual or interim accounts, it results or there is a risk of resulting that the Company's assets will not cover its liabilities within the next three months.</p> <p>10.3 The General Assembly shall be convened where there is a proposal to sell or otherwise dispose of assets having a value that exceeds 5% of the Company's total assets, as shown in its latest audited financial statements.</p> <p>10.4 The General Assembly shall be convened when the Company, within the first 2 years after its registration, proposes to purchase assets which belong to a Shareholder and which value exceeds 5% of the Company's assets, as shown in its latest audited financial statements.</p> <p>10.5 In circumstances set out in section 10.3. and 10.4. above, the General Assembly shall decide on the basis of a certified auditor's report submitted to such assembly, unless the acquisition is made on a stock exchange or forms part of the ordinary business of the Company.</p> <p>10.6 The Shareholders shall organize quarterly meetings with the Administrators to review the actions of the Administrators between the quarterly meetings, discuss issues related to the Company administration and resolve matters that are subject to the Shareholder's Assembly approval.</p> <p>10.7 In circumstances set out in sections 10.3. to 10.6. above, the General Assembly may pass an advisory resolution approving or condemning the conduct of the Administrators.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 11 Mënyra e Thirrjes e Asamblesë së Ortakëve</p> <p>11.1 Asambleja e Përgjithshme vendos për çështjet e paraqitura në nenet e mësipërme 9 dhe 10, nëpërmjet thirrjes së mbledhjeve.</p> <p>11.2 Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga një prej Administratorëve ose nga secili prej Ortakëve.</p> <p>11.3 Asambleja e Përgjithshme mbledhet në selinë e Shoqërisë, në selinë e një dege të saj, Shqipëri apo</p>	<p style="text-align: center;">Article 11 Method of Convening the Shareholders Assembly</p> <p>11.1 The General Assembly can resolve the matters set out in Articles 9 and 10 above, through convocations in meeting.</p> <p>11.2 The General Assembly can be convoked by one of the Administrators, or any of the Shareholders.</p> <p>11.3 The General Assembly shall take place in the registered legal seat of the Company or its branches in Albania or any other country, or through</p>

<p>në ndonjë shtet tjetër, ose nëpërmjet platformave elektronike të komunikimit.</p> <p>11.4 Ortakët gëzojnë të drejtën të përfaqësohen nga një person tjetër në përputhje me nenin 85 të Ligjit të Shoqërive.</p> <p>11.5 Ortakët do të njoftohen për Asamblesë e Përgjithshme dhe përmbajtjen e rendit të ditës së takimit me postë të regjistruar ose postë elektronike të paktën shtatë ditë përpara mbledhjes së planifikuar të Asamblesë.</p> <p>11.6 Nëse shoqëria mbetet me vetëm një ortak dhe nëse vendoset nga Ortaku i Vetëm, ky i fundit mund të vendosë të heqë dorë nga formalitetet për thirrjen e mbledhjes dhe vendimet e Asamblesë së Përgjithshme mund të merren në formë të shkruar të firmosura nga Ortaku i Vetëm pa u kërkuar të mbahet procesverbal.</p> <p>11.7 Vendimet e Ortakut të Vetëm do të regjistrohen në regjistrin e vendimeve.</p>	<p>electronic platforms of communication.</p> <p>11.4 The Shareholders can be represented by another person in compliance with article 85 of the Company Law.</p> <p>11.5 The Shareholders shall be notified about the General Assembly and the content of the meeting agenda by registered post or electronic mail at least seven days in advance before the planned date of the meeting.</p> <p>11.6 If the Company shall remain with a sole shareholder and if the Sole Shareholder so decides, the latter can waive the formalities for the convocation of the meeting and resolutions of the General Assembly can be taken in a written form executed by the Sole Shareholder and no minutes are required to be taken.</p> <p>11.7 The resolutions of the Sole Shareholder shall be registered in the register of decisions.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 12 Mbajtja dhe Ruajtja e Procesverbaleve dhe Vendimeve</p> <p>12.1 Administratorët duhet të mbajnë dhe të ruajnë procesverbalet e çdo mbledhjeje të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve, në përputhje me kërkesat e nenit 90 të Ligjit të Shoqërive.</p> <p>12.2 Nëse nuk mbahet procesverbal sipas nenit 11.6 më sipër, Administratorët duhet të kujdesen të regjistrojnë vendimet me shkrim në regjistrin e vendimeve.</p>	<p style="text-align: center;">Article 12 Keeping of minutes and/or resolutions</p> <p>12.1 The Administrators shall keep the minutes of each General Assembly meeting in compliance with article 90 of the Company Law.</p> <p>12.2 In case no minutes are taken in accordance with article 11.6 above, the Administrators shall take care to register the written resolutions in the register of decisions.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 13 Administratorët</p> <p>13.1 Shoqëria drejtohet nga një ose më shumë Administratorë sipas vendimit të Asamblesë. Administratori/ët mund të jenë të çdo kombësie dhe nuk është e nevojshme të jenë rezidentë në Shqipëri.</p> <p>13.2 Në momentin e miratimit të këtij Statuti, Shoqëria drejtohet nga një Administrator, i cili do të jetë:</p> <p style="padding-left: 20px;">- Z. Umut MISIRCI, shtetas turk, lindur më 22.5.1980, në Bornova, Turqi, identifikuar me Pasaportën Nr. U21796363.</p> <p>13.3 Kohëzgjatja e mandatit të Administratorit është për një periudhë 5 vjeçare, me të drejtë</p>	<p style="text-align: center;">Article 13 The Administrators</p> <p>13.1 The Company is managed by one or more Administrators in accordance with the resolution of the Shareholder's Assembly. The Administrator/s of the Company can be of any nationality and need not reside in Albania.</p> <p>13.2 At the moment of adoption of these Articles of Association the Company is managed by one Administrator:</p> <p style="padding-left: 20px;">- Mr. Umut MISIRCI, Turkish citizen born on 22.5.1980 in Bornova, Türkiye, identified with the Passport document No: U21796363.</p> <p>13.3 The mandate of the Administrator(s) is 5 years, with the possibility for re-appointment.</p>

Handwritten signature

Handwritten signature

Handwritten signature

<p>ripërtëritje të këtij mandati.</p> <p>13.4 Menjëherë pas pranimit të emërimit të tyre, Administratori/ët pranojnë se marrëdhënia e tyre me Shoqërinë ndërtohet mbi baza mirëbesimi; në këtë drejtim vendimi për heqjen e tyre në çdo kohë pa dhënë asnjë shkak e nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Ortakëve do të konsiderohet si arsye e ligjshme për shkarkimin e tyre, në përputhje me ligjet përkatëse.</p>	<p>13.4 Upon acceptance of their appointment, the Administrator(s) shall acknowledge that his/her/their relationship with the Company is on a fiduciary basis; in this respect, the decision to dismiss the Administrator at any time and without giving any cause by means of a resolution of the Shareholders Assembly is deemed a legitimate reason for the dismissal, in compliance with the applicable laws.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 14 Kompetencat dhe Detyrimet</p> <p>14.1 Secili prej Administratorëve individualisht dhe pa asnjë kufizim ka të drejtë të bëjë:</p> <p>14.1.1 Thirrjen e Asamblesë së Përgjithshme, në rastet e specifikuar në nenin 10;</p> <p>14.1.2 Menaxhimin e aktivitetit tregtar të shoqërisë nëpërmjet zbatimit të politikave tregtare dhe planeve të përcaktuara nga Asambleja e Përgjithshme;</p> <p>14.1.3 Përfaqësimin dhe angazhimin e Shoqërisë në marrëdhënie me të tretët;</p> <p>14.1.4 Të sigurohen për mbajtjen në mënyrë të përshtatshme të dokumenteve dhe librave kontabël të Shoqërisë;</p> <p>14.1.5 Përgatitjen dhe firmosjen e bilancit vjetor, bilancit të konsoliduar dhe raportit të ecurisë së veprimtarisë së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve që i paraqiten për miratim Asamblesë së Përgjithshme;</p> <p>14.1.6 Kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, kur është e nevojshme;</p> <p>14.1.7 Raportimin përpara Asamblesë së Përgjithshme, lidhur me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e transaksioneve me rendësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë ose ndryshimin e kushteve të kontratave materiale për Shoqërinë;</p> <p>14.1.8 Kryerjen e detyrave të tjera të caktuara në ligj ose me vendim të Asamblesë së Ortakëve kohë pas kohe.</p> <p>14.2 Administratori/ët mbikëqyrin dhe sigurojnë që të punësuarit, auditorët dhe këshilltarët e Shoqërisë të veprojnë me kujdesin e duhur dhe të mbrojnë sa më mirë interesat e Shoqërisë.</p> <p>14.3 Secili prej Administratorëve, nën përgjegjësinë e tij, mund t'i delegojë pjesërisht ose për një veprim të caktuar të drejtat e tij një personi të tretë me autorizim që përmban vulën e Shoqërisë.</p>	<p style="text-align: center;">Article 14 The Powers and Duties</p> <p>14.1 Any of the Administrators shall each individually and without any limitation be entitled to:</p> <p>14.1.1 Convoke the General Assembly in cases envisaged by Article 10;</p> <p>14.1.2 Manage the Company's business by implementing the commercial policies and plans defined by the General Assembly;</p> <p>14.1.3 Represent and bind the Company in relation with third parties;</p> <p>14.1.4 Ensure that the necessary accountancy books and documents are properly maintained;</p> <p>14.1.5 Provide for and sign the annual statement of accounts and consolidated accounts and the performance report, together with the proposals to the General Assembly for the distribution of profits;</p> <p>14.1.6 Submit Company's data to be registered to the National Registration Business where applicable;</p> <p>14.1.7 Report to the General Assembly with respect to the implementation of business policies and to the realization of transactions of particular importance for Company performance, or amendment of the terms of any material contract for the Company;</p> <p>14.1.8 Perform other duties set by law or by resolution of the Shareholder's Assembly from time to time.</p> <p>14.2 The Administrator(s) shall supervise and ensure that the employees, the auditors and advisers of the Company act with due care and in the best interest of the Company.</p> <p>14.3 Any of the Administrators can, under his sole responsibility, delegate partially or for a specific action his rights to a third person by authorization holding the seal of the Company.</p> <p>14.4 The Administrator has the right to perform any ordinary or extraordinary administration action, with the exception of the following actions for</p>

<p>14.4 Administratori ka të drejtë të kryejë çdo veprim administrimi të zakonshëm apo të jashtëzakonshëm, me përjashtim të atyre veprimeve vijuese për të cilat kërkohet miratimi paraprak i Asamblesë së Ortakëve sipas nenit 9 të këtij Statuti, veçanërisht në lidhje me çështjet e mëposhtme:</p> <p>14.4.1 fillimin, pushimin apo zgjidhjen me pajtim të mosmarrëveshjeve gjyqësore për pretendime që tejkalojnë vlerën prej 1.000.000 USD;</p> <p>14.4.2 pezullimin e veprimtarinë e tregtare të shoqërisë;</p> <p>14.4.3 hyrjen në çdo marrëveshje të re me vlera apo angazhime të konsiderueshme materiale për shoqërinë</p> <p>14.4.4 të shesë, të përcjellë, të transferojë, të japë me qira ose të disponojë, ose të japë një opSION ose të drejtë tjetër për të blerë, marrë me qira ose në ndonjë mënyrë tjetër për të blerë (qoftë në një transferim ose një seri transferimesh) të gjitha ose një pjesë materiale të pronave të shoqërisë dhe asetet ku aktivet materiale ose pasuria nënkupton asetet ose pronat me vlerë më të madhe se 1.000.000 USD;</p> <p>14.4.5 të marrë hua ose ndryshe të ketë borxh mbi 1.000.000 USD ose të krijojë një linjë kredie në një shumë më të madhe se kjo shumë;</p> <p>14.4.6 të japë kredi mbi 50.000 USD;</p> <p>14.4.7 të japë një garanci ose garanci të ndryshme nga garancitë ose letrat me vlerë të dhëna në rrjedhën e zakonshme të biznesit;</p> <p>14.4.8 të vendosë të ndërmarrë veprime juridike materiale, ose të zbatojë ose mbrojë ndonjë nga të drejtat ose detyrimet e tij thelbësore, përveç siç kërkohet në përgjigje të një nevoje urgjente; dhe</p> <p>14.4.9 të lidhë kontrata me ortakët ose ndonjë degë/bijë të tyre që kërkojnë shpenzime që tejkalojnë një total prej 100.000 USD në vit.</p>	<p>which the prior approval of the Shareholders' Assembly is required pursuant to Article 9 of these Articles of Association, particularly in relation to the following issues:</p> <p>14.4.1 initiation, termination or settlement of judicial claims exceeding the value of USD 1.000.000;</p> <p>14.4.2 suspension of the Business activity;</p> <p>14.4.3 entering into any new material agreements or similar commitments;</p> <p>14.4.4 sell, convey, transfer, lease or otherwise dispose of, or grant an option or other right to purchase, lease or otherwise acquire (whether in one transfer or a series of transfers) all or a material part of the Company's properties and assets where material assets or property means assets or properties with a value in excess of USD 1.000.000;</p> <p>14.4.5 borrow or otherwise incur Indebtedness in excess of USD 1.000.000 or establish a credit line in an amount in excess of such amount;</p> <p>14.4.6 make loans in excess of USD 50.000;</p> <p>14.4.7 grant a guarantee or security other than guarantees or securities granted in the ordinary course of business;</p> <p>14.4.8 determine to take material legal action, or enforce or defend any of its substantive rights or obligations, other than as required in response to an emergency; and</p> <p>14.4.9 enter into contracts with Shareholders or any Affiliates thereof requiring expenditures in excess of an aggregate of USD 100.000 per year.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 15</p> <p style="text-align: center;">Detyrimi i Besnikërisë dhe Përgjegjësia</p> <p>15.1 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të Ligjit të Shoqërive, Administratorët detyrohen:</p> <p>15.1.1 të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në këtë Statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi, që përfshin vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së Shoqërisë në mjedis;</p> <p>15.1.2 të ushtrojnë kompetencat që u njihen me ligj ose nga ky statut, vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;</p> <p>15.1.3 të vlerësojnë me përgjegjësi çështjet për të cilat merret vendim;</p> <p>15.1.4 të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit,</p>	<p style="text-align: center;">Article 15</p> <p style="text-align: center;">The Fiduciary Duties and Liability</p> <p>15.1 In addition to the general and fiduciary duties expressed by Articles 14, 15, 17 and 18 of the Company Law, the Administrators must:</p> <p>15.1.1 Perform their duties established by law or these Articles of Association in good faith in the best interests of the Company as a whole which includes the sustainability of its operations in the environment;</p> <p>15.1.2 Exercise powers granted to them by law or these Articles of Association only for the purposes established therein;</p> <p>15.1.3 Give adequate consideration to matters to be decided;</p> <p>15.1.4 Avoid actual and potential conflicts between their own personal interests and those of the Company;</p>

<p>prezent apo të mundshëm, të interesave të tyre personale me ato të Shoqërisë;</p> <p>15.1.5 të garantojë miratimin e dhënë për marrëveshjet e përkruara në dispozitat e pikës 3 të nenit 13 të Ligjit të shoqërive;</p> <p>15.1.6 të ushtrojnë detyrat e tyre me profesionalizëm dhe kujdesin e nevojshëm.</p> <p>15.2 Administratorët mbajnë përgjegjësi për çdo veprim apo mungesë veprimi, me përjashtim të rasteve kur veprimi apo mosveprimi është kryer në mirëbesim, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacionit të lidhur në mënyrë të drejtpërdrejtë me qëllimet e Shoqërisë. Në çdo rast emërimi dhe punësimi i administratorëve në shoqëri të tjera të grupit nuk do të konsiderohet si shkelje e konkurrencës.</p> <p>15.3 Në rast të shkeljes së detyrës dhe standardeve profesionale, sipas pikave 15.1 dhe 15.2 të këtij neni, Administratori është i detyruar të dëmshpërblejë Shoqërinë për dëmet që rrjedhin nga kryerja e shkeljes. Gjithashtu, Administratori duhet t'i kalojë Shoqërisë çdo fitim personal që ka realizuar gjatë kryerjes së këtyre veprimeve të parregullta. Ai ka barrën e provës për të vërtetuar se kryen detyrat e tij në rregull dhe sipas standardeve. Kur shkelja është kryer nga me shumë se një Administrator ata janë përgjegjës ndaj Shoqërisë në mënyrë solidarë dhe veçmas.</p>	<p>15.1.5 Ensure that approval is given where contracts described in paragraph 3 of Art. 13 of the Company Law are concluded;</p> <p>15.1.6 Exercise reasonable care and skills in the performance of their functions.</p> <p>15.2 The Administrators may be held liable for any action or failure to act unless the action or omission was made in good faith, based upon reasonable inquiry and information, and rationally related to the purposes of the Company. In any case the appointment or employment of the administrators in any group of companies shall not be considered as a breach of competition clause.</p> <p>15.3 In case of violation of duties and the standard of diligence referred to in section 15.1. and section 15.2, an Administrator has to compensate the Company for any damage which occurred due to the violation. He shall also pass on to the Company any personal profits made in violation of his duties. He has the burden of proving compliance with the duties and standards. In case the violation has been committed by more than one Administrator, all the Administrators in question are jointly and severally liable.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 16 Eksperti Kontabël i Autorizuar</p> <p>16.1. Asambleja e Ortakëve do të caktojë audituesin e Shoqërisë, nëse kërkohet ose është e përshtatshme për veprimtarinë e Shoqërisë.</p> <p>16.2. Ekspertët duhet të kryejnë funksionet audituese në përputhje me legjislacionin shqiptar.</p>	<p style="text-align: center;">Article 16 Certified public accountant</p> <p>16.1. The Shareholder's Assembly shall appoint the auditor of the Company, if required or desirable for the operation of the Company.</p> <p>16.2. The auditors shall carry out the auditing functions in accordance with Albanian law.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 17 Viti ekonomiko-financiar</p> <p>17.1 Viti ekonomiko-financiar fillon në ditën e parë të muajit Janar dhe përfundon në ditën e 31-të të muajit Dhjetor të secilit vit.</p>	<p style="text-align: center;">Article 17 Economic-Financial Year</p> <p>17.1 The economic-financial year starts on the first day of January and ends on the 31st day of December of each year.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 18 Mbajtja e Llogarive</p> <p>18.1. Shoqëria do të mbajë llogaritë në lekë dhe në monedhë të huaj.</p>	<p style="text-align: center;">Article 18 Bookkeeping</p> <p>18.1. The Company will carry out the bookkeeping in Albanian Lek and in foreign currency.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 19 Llogaritja dhe Shpërndarja e Fitimit</p>	<p style="text-align: center;">Article 19 Profit Computation and Distribution</p>

<p>19.1 Fitimi i Shoqërisë përcaktohet në bazë të bilancit (pasqyrave financiare) të miratuar(a) nga Asambleja e Përgjithshme. Shpërndarja e fitimit do të caktohet nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me këtë Statut, marrëveshjet e ortakëve dhe me ligjet e zbatueshme.</p> <p>19.2 Në bazë të Ligjit për Shoqëritë, Shoqëria mund të shpërndajë fitimin tek Ortaket vetëm nëse pas kësaj shpërndarje:</p> <p>19.2.1 Asetet e Shoqërisë mbulojnë tërësisht detyrimet e kësaj të fundit; dhe</p> <p>19.2.2 Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm.</p> <p>19.3 Secili prej Administratorëve mund të lëshojë një "certifikate të aftësisë paguese", e cila konfirmon shprehimisht se shpërndarja e propozuar përmbush kërkesat e pikës 19.2 më sipër. Ndërsa kur gjendja e Shoqërisë tregon se shpërndarja e propozuar nuk i përmbush këto kritere sipas pikës 19.2 më sipër, administratorët nuk mund ta lëshojnë këtë certifikatë.</p> <p>19.4 Administratorët përgjigjen ndaj shoqërisë për vërtetësinë e certifikatës se aftësisë paguese.</p>	<p>19.1 The Company profit shall be determined on the basis of the balance sheet approved by the General Assembly. Distributions will be determined by the General Assembly in accordance with these Articles of Association, Shareholders' Agreements and the applicable laws.</p> <p>19.2 In compliance with the Company Law, the Company may make a distribution to the Shareholders only in the event after the payment of such distributions:</p> <p>19.2.1 the Company's assets will fully cover its liabilities, and</p> <p>19.2.2 the Company will have sufficient liquid assets to make payments of its liabilities as they fall due in the next twelve months.</p> <p>19.3 Any of the Administrators can issue a 'solvency certificate', which explicitly confirms that the proposed distribution meets the valuation as per section 19.2. above. Where the accounts of the Company indicate that the proposed distribution cannot meet the valuation of section 19.2 above, the Administrators may not issue the solvency certificate.</p> <p>19.4 The Administrators are responsible to the Company for the correctness of the solvency certificate.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 20 Ndryshimi i Formës Ligjore</p> <p>20.1. Forma ligjore e Shoqërisë mund të ndryshojë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme sipas nenit 9 të Statutit dhe në përputhje me dispozitat respektive në Legjislacionin Shqiptar.</p> <p>20.2. Shoqëria e re do të përmbushë të gjitha procedurat ligjore të regjistrimit në Shqipëri.</p>	<p style="text-align: center;">Article 20 Modification of the Legal Form</p> <p>20.1. The legal form of the Company can be changed upon a decision of the General Assembly as per Article 9 herein and in accordance with the respective provisions of the Albanian Law.</p> <p>20.2. The new Company will fulfill all registration procedures legally required in Albania.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 21 Prishja e Shoqërisë</p> <p>21.1 Shoqëria mund të prishet në rrethanat e mëposhtme:</p> <p>21.1.1 me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;</p> <p>21.1.2 me hapjen e procedurave të likuidimit/falimentimit;</p> <p>21.1.3 me vendim të Gjykatës;</p> <p>21.1.4 për arsye të tjera të parashikuara nga Ortaket në çdo kohë.</p> <p>21.2 Administratori(ët) regjistrojnë prishjen e Shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit në përputhje me nenin 43 të Ligjit nr. 9723, datë</p>	<p style="text-align: center;">Article 21 Company Dissolution</p> <p>21.1 The Company can be dissolved under the following circumstances:</p> <p>21.1.1 by decision of the General Assembly;</p> <p>21.1.2 by opening of an insolvency/liquidation procedure;</p> <p>21.1.3 by court decision;</p> <p>21.1.4 for other reasons to be provided for by the Shareholders from time to time.</p> <p>21.2 The Administrators shall report the dissolution to the National Business Centre in accordance with Art. 43 of Law No. 9723, dated 5.7.2007 "On the</p>

<p>3.05.2007 "Për regjistrimin e biznesit", i ndryshuar ("Ligji 9723/2007"). Në rast se prishja e Shoqërisë bëhet me vendim gjykate, gjykata, në përputhje me nenin 45 të Ligjit 9723/2007, ia dërgon vendimin për regjistrim regjistrit tregtar.</p>	<p>registration of the business", as amended ("Law 9723/2007"). In the event of dissolution by court decision, the court shall transmit the decision to the commercial register for the registration in accordance with Art. 45 of Law 9723/2007.</p>
<p>Neni 22 Të tjera</p> <p>22.1 Çdo çështje tjetër, e cila nuk është përmendur në këtë statut, do të rregullohet nga dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.</p>	<p>Article 22 Other</p> <p>22.1 All other issues not specifically provided for in these Articles of Association shall be subject to the provisions of Company Law.</p>
<p>ORTAKËT:</p>	<p>SHAREHOLDERS:</p>
<p>FEKA İNŞAAT SANAYİ VE TİCARET A.Ş. <u>UMUT MISIRCI</u> <i>Li, 9</i> İNŞAAT SANAYİ ve TİCARET A.Ş.</p> <p>Përfaqësuar nga/Represented by Z./Mr. Umut MISIRCI</p> <p>5-R D.E.G SHPK <u>Amarilda Hoxha</u></p> <p>Utku Yönder <u>Utku Yönder</u></p> <p>Naim Idrizi <u>Naim Idrizi</u></p> 	